



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 korrik 2014
Nr. ref.:RK684/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI58/14

Parashtrues

Shefqet Hasimi

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,
KA. nr. 89/2014, të 6 shkurtit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Shefqet Hasimi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, KA. nr. 89/2014, i 6 shkurtit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, KA. nr. 89/2014, të 6 shkurtit 2014, përmes të cilit ishte vërtetuar aktvendimi, Nr. regj. 53490/13, i 20 janarit 2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Kundërvajtje (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore në Prishtinë). Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit të lartcekur e kishte shpallur parashtruesin e kërkesës përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes në komunikacion.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 prill 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI58/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI58/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 28 prill 2014, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën e Apelit.
8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendimet e caktuara të ngritura ndaj tij.
9. Më 1 korrik 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 23 gusht 2013, Stacioni Policor Jugu në Prishtinë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte ushtruar kërkesë për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të kryerjes së kundërvajtjes

(mosvënie e rripit të sigurisë) në shkelje të nenit 198, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 02/ L- 70 për sigurinë në komunikacion.

11. Më 23 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi Nr. regj. 53490/13) e kishte shpallur parashtruesin e kërkesës përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes (drejtimi i automjetit pa rrip të sigurisë) sipas nenit 198, paragrafi 1 të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor (në tekstin e mëtejshëm: LSKRR), dhe e kishte gjobitur me gjobë në shumën prej 35 (tridhjetë e pesë) euro.
12. Kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit.
13. Më 6 nëntor 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi KA. Nr. 1155/2013) aprovoi ankesën e parashtruesit si të bazuar dhe abrogoi Aktvendimin Nr. regj. 53490/13, të 23 shtatorit 2013, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke ia kthyer gjykatës së shkallës së parë lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.
14. Gjykata e Apelit konstatoi se Gjykata Themelore në Prishtinë parashtruesin e kishte shpallur përgjegjës vetëm për kryerjen e kundërvajtjes sipas nenit 198, paragrafi 1 të LSKRR-së, drejtimin e automjetit pa rrip të sigurisë, ndërsa për dy kundërvajtjet e tjera, përkatësisht drejtimin e automjetit pa i ndezur dritat dhe për sjellje të pahijshme ndaj zyrtarit policor, Gjykata e lartcekur nuk kishte marrë asnjë vendim. Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit vendosi që Gjykata Themelore në Prishtinë duhet të procedojë me plotësimin e procedurës dhe të vendosë lidhur me të gjitha kundërvajtjet.
15. Më 5 dhjetor 2013, parashtruesi, te Kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, paraqiti kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës nga procedura kundërvajtëse duke pohuar se e njëjta gjatë procedurës ishte treguar e njëanshme.
16. Më 20 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës Themelore refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
17. Më 20 janar 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi Nr. regj. 53490/13) shpalli parashtruesin e kërkesës përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes në komunikacion, sipas nenit 198, paragrafi 1 i LSKRR-së, drejtimi i automjetit pa rrip të sigurisë. Kjo Gjykatë, më tej, pezulloi procedurën kundërvajtëse ndaj parashtruesit përkitazi me kundërvajtjen sipas nenit 122, paragrafi 1 të LSKRR-së (drejtimi i automjetit pa ndezjen e dritave), ndërsa përkitazi me sjelljen e pahijshme ndaj zyrtarit policor, konstatoi se ky veprim nuk cilësohet si kundërvajtje, duke e shënuar si vërejtje për sjellje të parashtruesit.
18. Kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës, me pretendimin për aplikim të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës së kundërvajtjes, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit.

19. Më 6 shkurt 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi KA. nr. 89/2014) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Nr. regj. 53490/13, të 20 janarit 2014.
20. Gjykata e Apelit konstatoi si në vijim:

[...]

“Kolegji vlerësoj se gjykata e shkallës së parë, gjatë zbatimit të procedurës kundërvajtëse, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Kurse gjoha e shqiptuar ndaj të pandehurit Shefqet Hasimi, konform të nenit 7 të LK-së, në shumë prej 35 (tridhjetë e pesë) €, konsiderohet se është caktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, peshës së veprës së kryer dhe rrethanave nën të cilat është kryer vepra kundërvajtëse, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka baze ligjore për ndryshimin e aktvendimit të goditur.”

21. Më 26 shkurt 2014, kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë (Nr. regj. 53490/13, të 20 janarit 2014) dhe të Gjykatës së Apelit (KA. nr. 89/2014, të 6 shkurtit 2014), parashtruesi i kërkesës, në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, parashtroi kërkesë për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.
22. Më 5 mars 2014, Prokurori i Shtetit, në njoftimin e tij, KMLP. I. Nr. 2/14, konsideroi se nuk ka bazë ligjore për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës si në vijim:

“Me këtë kërkesë drejtuar gjykatës kushtetuese të Kosovës me marrjen e Aktvendimeve në shkelje të Kushtetutës, duke shkelur të drejtën e qytetarit që para gjykatës të trajtohem të barabart para ligjit dhe Kushtetutës, e jo në Diskriminimin, dhe në shkelje brutale të ligjit, duke aplikuar Ligjin, i cili në rastin e shqiptimit të dënimit nuk ka asnjë provë se unë Shefqet Hasimi, Zyrtar në Ministrinë e Drejtësisë me datën 09.07.2013 kam ra në kundërshtim me ligjin. Kolegjit i propozoj që të shqyrton me kujdes të veçantë në mënyrë që të konstatohet se ka shkelje të Ligjit, Kushtetutës e në veçanti kur kolegji i gjykatës së apelit vendos dy herë për të njëjtën çështje.”

24. Parashtruesi, në kërkesën e tij, nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri i janë cenuar dhe cila dispozitë kushtetuese në veçanti mbështet kërkesën e tij.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjykata gjithashtu merr parasysh nenin 48 të Ligjit që parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

28. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të konstatojë se [...]”Kolegjit i propozoj që të shqyrton me kujdes të veçantë në mënyrë që të konstatohet se ka shkelje të Ligjit, Kushtetutës e në veçanti kur kolegji i gjykatës së apelit vendos dy herë për të njëjtën çështje”.

29. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë nuk thekson se cila e drejtë i është shkelur dhe cili nen i Kushtetutës mbështet kërkesën e tij.

30. Gjykata, po ashtu, ripërsërit se Gjykata Kushtetuese nuk mund ta zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, ashtu edhe të asaj materiale (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

31. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të cituar në paragrafin 28, Gjykata vëren që arsyetimi i dhënë me aktvendimin e Gjykatës së Apelit është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituaniës*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

32. Për më tepër, parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë (shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, GJEDNJ, Nr. 53363/99, Vendimi i 31 majit 2005). Parashtruesi nuk saktësoi se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë mbështesin pretendimin e tij, ashtu siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

33. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës që parasheh: *“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse: a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie; dhe d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*


PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) a) dhe d) e me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 1 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani